Asambleja
01.Nr.XIII
Deçan,dt.31.10.2022

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e XIII-të me radhë, respektivisht mbledhja e VIII-të e rregullt e Asamblesë Komunale, me dt.31.10.2022.

Në mbledhje ishin prezent: 25 anëtarë të asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale, OJQ.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit financiar 6(gjashtë) dhe 9(nëntë) mujor,
3. Marrja e vendimit për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës me Organizatën për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, participim në projektin e përbashkët nga lëmia e blegtorisë, në shumën 17,600.00 €.
4. Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve/Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Deçanit,
5. Njoftim i Kryesuesve të Komisioneve të kuvendit për punën e tyre (Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, parcela nr. nr.00429-0 Zk.Deçan, , parcela nr. 01098-0 Zk.Dranoc, parcela nr. 00736-0 Zk.Rastavicë, parcelat nr.1256-0, nr.1257-0 dhe nr.4690-0 Zk Deçan, Komisionit për trajtimin e qenve endacak dhe Njoftim nga Kryesuesit e Komisioneve dhe grupeve punuese për hartimin e akteve komunale),
6. Të ndryshme (Përgjigjet e Kryetarit të Komunës në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit të cilat dorëzohen me shkrim në Sekretari të Kuvendit, së paku tri ditë para mbledhjes).

Kryesuesi e hapi mbledhjen e XIII-të me radhë, gjegjësisht mbledhja e VIII-të e rregullt e Kuvendit, duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 25 anëtarë të Kuvendit (mungojnë me arsye, Arjan Dobraj dhe Florim Mataj).

Kryesuesi- e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë, dhe Rekomandimin e Ministrisë së Financave-Zyra Qendrore e Tatimit në pronë për shfuqizimin e Rregullores për tatimin në Pronë për vitin 2023.

Mon Selmonaj- propozon që pika nr. 5-Njoftim i Kryesuesve të Komisioneve të kuvendit për punën e tyre, të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Miratohet njëzëri rendi i punës pa pikën nr.5 si dhe Rekomandimi i Ministrisë për shfuqizim të rregullores së tatimit në pronë.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Yllarta Thaqi- ka vërejtje, sepse çdo pyetje imja nuk e ka përgjigjen ka thënë ajo.

Orges Tafilaj- fq.2. korrektim i korrektimit të debatit, i cili ka qenë mes meje, drejtorit të inspekcionit dhe drejtoreshës së buxhetit, te pyetjet e mia një pjesë e tyre nuk është përfshi ndërsa janë përfshi të gjitha përgjigjët e Kryetarit në këto pyetje, fq.3 duhet të korrigjohet dhe nuk duhet të jetë "25" por "2025".

Faton Selmanaj-fq.3 duhet të plotësohet, Investimet kapitale siç janë ato te bjeshka e Belegut nuk mund të kryhen me këtë buxhet.

Albesa Cacaj- në fq.6. te rregullorja e transportit kam deklaru, si [illegible]
cila e rregullon çështjen e stacionit të autobusëve ndërsa në realitet ne nuk kemi fare stacion të autobusëve.
Me këto vërejtje dhe korrigjime miratohet procesverbali(Ndryshimet në procesverbal do të bëhen pas dorëzimit të vërejtjeve me shkrim nga asamblistët që kanë bërë vëretje).

II. Shqyrtimi i Raportit financiar 6(gjashtë) dhe 9(nëntë) mujor.

Faton Selmanaj- te pjesa e përmbarimeve në raport ka cekë se edhe Ndërmarrja Higjiena dy herë sipas raportit e ka qua komunën në përmbarim dhe një ndërmarrje e themeluar me inicimin e Komunës dhe me ju qu në përmbarim është turp ka thënë ai, disa mediume (gazeta) çfarë pune kanë bërë që e kanë qu komunën në përmbarim ka pyet ai.
Mon Selmanaj-përkundër përpjekjes dhe angazhimit tonë serioz si opozitë dhe rekomandimeve të auditorit të jashtëm, prap po përsëriten të njëjtat gabime, raporti pa asnjë shifër krahasuese është jashtë çdo kriteri të raportimit financiar ka thënë ai, në raport duhet të paraqiten të dhënat e buxhetit të planifikuar dhe përqindja e realizimit në 9 muaj, në vazhdim ka shtruar pyetjen sa ka qenë buxheti i alokuar për tre mujorin e tretë të vitit dhe sa është realizuar, sa është përqindja e realizimit të hyrave gjatë kësaj periudhe. Sa është përqindja e realizimit të buxhetit te kategoria Mallra dhe shërbime dhe te kategoria investime kapitale. Sa është % e buxhetit të shpenzuar për subvencione krahasu me planifikim. Të dhënat duhet të prezantohen në formë sintetike e pastaj në formë analitike, duhet të pasqyrohen në raport të dhënat krahasuese me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në vazhdim ka cekë vendimet gjyqësore përmbarimore-72 raste, shuma 1.281.428 euro, Kontratat për shërbime të veçanta, dreka, karburante , fatura nr. 19/2022 shuma 13,558.00 euro gjendet ne dy programe dhe kërkon sqarim për të gjitha.
Blinera Lokaj-nga të gjeturat e raportit ka cekë shpenzimet dreka, karburante, furnizim për zyre që të gjitha shpenzime enorme, pastaj kërkon sqarim për shpenzimin për dy dreka me dt.28 shkurt shuma 7000 euro, te drejtoria e buxhetit me dt.25 maj janë 5 dreka në vende të ndryshme.
Hyri Dobrunaj- në diskutimin e saj rreth raportit 9 mujor ka filluar nga Zyra e Kryetarit, në të cilën ka thënë se janë 14 vendime gjyqësorë përmbarimore dhe ma shumë më intereson sa paguajmë ne si komunë ndëshkime te vendimet gjyqësore, kërkon sqarim te shuma prej 362.80 euro e cila paguhet çdo muaj-çka është ajo, shërbimet e shtypjes-ka paguar 50 euro, te subvencionet-kryetari ma shumë se 60% i ka qu për emergjenca, te drejtoria për Administratë janë dy vendime gjyqësore te pagat dhe kërkoj sqarim për to, drejtoria e Inspekcionit 5914 euro shpenzim mallra dhe shërbime-sqarim, Shërbime kontraktuese tjera te drejtoria e Inspekcionit-kërkon sqarim, Zyra e Kuvendit 6000 euro dreka- kërkon sqarim, sepse drekat dhe darkat nuk i ka shpenzua kuvendi por nëse i ka ba kryesuesi le të tregon, kërkon sqarim për shpenzimin e mjeteve ku shkruan Veton Shala. Drejtoria e Buxhetit dreka dhe karburante, kërkon sqarim për dy shuma, thot se 32% janë ma pak shpenzime te projektet kapitale, sqarim për shumën 38.965 euro për NTSH Higjiena, te drejtoria e Shërbimeve publike-çfar projekte kapitale shërbime me energji -sqarim, Zyra për Komunitete zero kapitale, Drejtoria për bujqësi-sqarim për dreka dhe karburante, te drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim-zero kapitale, sqarim për dreka dhe karburante, te drejtoria për Gjeodezi-sqarim për dreka dhe karburante ndërsa zero kapitale, drejtoria për Urbanizëm-zero kapitale, Shërbimet rezidenciale –nuk i kemi nxjerrë shënimet, drejtoria për Kulturë- zero kapitale ndërsa kërkon sqarim për shpenzimet dreka, karburante, shërbime kontraktuese, kërkon sqarim për shumën 110,660 euro dreka, 100.00 euro shërbime kontraktuese.
Orges Tafilaj- shqetësim i joni është pagesat për dreka, karburante mbi 100.000 euro, mbi 100.000 euro dreka, mbi 1.2 milion euro shpenzim i buxhetit me përmbarues, dhe këtu kemi keq menaxhim të buxhetit, Kompania N.Large SHPK qka ban ka pyet ai, te shpenzimi i buxhetit me përmbarim vlene te ceket se dy here Ndërmarrja Higjiena e ka qu Komunën në përmbarim, poashtu edhe punëtorët e komunës e kanë qu komunën në përmbarim.
Halil Tolaj, drejtor i Inspekcionit- ka thënë se e çmoj punën që ka bërë Hyria por e hupi pak kontrollin te shifrat e shpenzimeve në drejtori të Inspekcionit sepse nuk janë 3614 euro dreka siq tha Hyria por në fakt janë 163 euro dhe mos e dezinformo opinionin për këto gjana.

Hyri Dobrunaj- thotë se krejt shifrat i kemi marrë nga raporti dhe kujdes me shprehjet sepse nuk e kam hupë kontrollin.
Leotrim Hadergjonaj-thotë se raporti duhet të shihet edhe në aspektin pozitiv jo vetëm në aspektin e shumave të shpenzuara por edhe punëve të kryera siq janë: përkrahja buxhetore e klubeve sportive të cilat nuk u përmendën fare, investimet kapitale të planifikuara për 2022 afërsisht 70% janë realizu, bursat e studentëve –janë realizua, subvencione për familjet në nevojë, subvencione për të sëmurët, subvencionet në përkrahje të OjQ-ve-janë realizua, Ndërmarrja Higjiena e ka një kontratë N'Shpi 14000 euro në muaj dhe nëse ka ndodhë që komuna nuk ka arrite me i krye obligimet ndaj saj, Ndërmarrja e ka ndërmarrë atë veprim të nxjerrjes së borgjit me përmbarues kjo ka ndodhë sepse i ka 50 punëtorë që duhet paguar në kohë të rregullt, Drejtoria e Ekonomisë së Deçanit viteve të fundit është shndërruar në ndërmarrje të turizmit, bujqësia zero investime kapitale sepse nuk kanë qenë të planifikuara në atë drejtori ndërsa dihet fakti për përkrahjen e kësaj drejtorie për bujqë, ka edhe shumë gjana dhe punë të tjera të mira që janë bërë e që e përgëzoj drejtoreshën e buxhetit publikisht.
Drejtoresha Dafina Cacaj- ka thënë se raportin e kini marrë të gjithë dhe janë shpenzime që komuna e ka bërë për mbarë vajtjen e punëve dhe funksionimin sa ma efikas.
Kryesuesi- me shpresën që në të ardhmen të punohet edhe ma shumë dhe rekomandimin që shpenzimet të ulen aty ku nuk rrezikohet kryerja efikase e punëve e mbylli debatin rreth kësaj teme.

III. Marrja e vendimit për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës me Organizatën për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, participim në projektin e përbashkët nga lëmia e blegtorisë, në shumën 17,600.00 €.

Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj për sqarime e ka ftua drejtorin e drejtorisë për BPZHR, Rifat Stojkaj, i cili sqaron se kjo shumë e mjeteve kërkohet për të krye komuna obligimet e veta nga marrëveshja me të cilën kemi përfituar 22 lopë qumështore te shpërndara ne muajin shkurt dhe tash për të ardhë kontingjenti i dytë prej 45 lopëve kërkohet që të kryejmë obligimet e pagesave për kontingjentin e parë, në vazhdim ai ka fole edhe për aktivitete tjera të drejtorisë që ai drejton, në mes tjerash ai ka cekë se jemi komuna me rritjen ma të madhe të rritjes së volumit të punimit të tokës.
Albesa Cacaj- pyet, shuma prej 17.600 euro , a janë për fazën e parë të lopëve, dhe nëse janë për kontingjentin e parë, a duhet prapë të votohet për kontingjentin e dytë shuma e mjeteve me të cilat participon komuna.
Orges Tafilaj- thotë, të ceket në procesverbal se dënoj gjuhën që ka drejtoresha e drejtorisë për Buxhet për opozitën dhe se drejtoresha nuk dha përgjigje në pyetjet e shtruara për raportin financiarë, ndërsa sa ju përket gjedheve, e përgëzoj drejtorin për angazhimin e tij, pastaj shtron pyetjen, a ka listë të fermerëve që do të përfitojnë.
Drejtori, Rifat Stojkaj- përgjigjet, në Marrëveshje thuhet që pas kryerjes së obligimeve në shumën 17600 euro, pastaj do të nënshkruhet marrëveshja e dytë për kontingjentin e dytë, dhe ju njoftoj se kanë aplikuar 166 fermer për kontingjentin e parë ku janë përzgjedhë 22 fermer përfitues, përzgjedhja është bërë nga komisioni që ka qenë i përbë nga 5 antarë, prej tyre 3-komuna dhe 2 – Shoqata Mëshqerra.
Hyri Dobrunaj- pyet, cilat janë kriteret për përfitim të lopëve.
Drejtori- përgjigjet, kriteret janë të publikuara në ueb faqen e komunës, por për sqarime ai lexon kriteret e publikuara.
Meqenëse nuk kishte diskutime tjera, kryesuesi e qiti ne votim, anëtarët e kuvendit njëzëri i miratojnë 17,600.00 € për kryerjen e obligimeve ndaj Marrëveshjes së Komunës me Organizatën për Zhvillim Rural(OZHR)) "Mëshqerra"-Prishtinë, participim në projektin e përbashkët nga lëmia e blegtorisë, nga i cili komuna ka përfituar dhe shpërndarë fermerëve 22 lopë qumështore.
IV.Formimi i Komisionit për përzgjedhjen e Drejtorëve/Zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Deçanit.
Kryesuesi e ka prezentu këtë pikë, pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë zyrtarit të DKA-së, Ramiz Bajramaj, i autorizuar nga drejtori i Arsimit për të dhënë sqarime, në vazhdim Ramiz Bajramaj ka

dhënë të gjitha sqarimet rreth propozimit, ai ka thënë se komisioni formohet për vitin shkollor 2022-2023, të propozuar sipas udhëzimit administrativ janë 1. Xhevat Bozhdaraj-DKA-Udhëheqës i Sektorit të Arsimit, 2. Avdyl Shala- Përfaqësues i pavarur i arsimit, dhe duhet të jetë, 3.Një anëtar nga MASH, i cili përcaktohet nga MASH, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, email zyrtar nga DKA.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë, dilema ime te ky komision është sepse në muajin shkurt ne e kemi votuar një vendim me të cilin është formua një komision i tillë, meqenëse kërkesa thirret në Udhëzimin Administrativ, atëherë nuk ju kemi referuar Udhëzimit sepse mos respektimi i nenit 1, 2, 3, 4 etj. Përbën shkelje të parimit të barazisë gjinore prandaj duhet të ceket, Komisioni për përzgjedhjen e Drejtorit /eshës Zëvendësdrejtorit/eshës të shkollave, ndërsa sa i përket anëtarit të dytë të propozuar për komision i cili duhet të jetë ekspert, kandidati i propozuar nuk e plotëson asnjë kriter të kërkuar sipas nenit 6 pika 3.1 të Udhëzimit Adminitsrativ.Rrjedhimisht nuk është ofruar asnjë dëshmi mbi plotësimin e këtyre kritereve ligjore, shto kësaj edhe mungesën e parimit të depolitizimit i cili është parim bazë për aprovimin e komisioneve vlerësuese. Për arsye parimore të cilat u renditen më lartë, në emër të këshilltarëve të LDK-së ka thënë ai, deklaroj se do të votojmë kundër aprovimit të këtij komisioni.
Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e drejtorisë për arsim, antarët e kuvendit me shumic votash e miratuan ate, rezultati votimit ishte, 14 për(pozita), 9 kundër (opozita). Me këtë vendim themelohet Komisioni për përzgjedhjen e Drejtorit /eshës Zëvendësdrejtorit/eshës të shkollave në Komunën e Deçanit, për vitin shkollor 2022/2023, në përbërje: 1. Xhevat Bozhdaraj-DKA-Udhëheqës i Sektorit të Arsimit, 2. Avdyl Shala- Përfaqësues i pavarur i arsimit, dhe, 3.Një anëtar nga MASH, i cili përcaktohet nga MASH, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, email zyrtar nga DKA.
V.Të ndryshme.
Në mungesë të kryetarit nuk ngritën çështje, por shtyhen për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

Asambleja
01.Nr.XIV
Deçan,dt.30.11.2022

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e XIV-të me radhë, respektivisht mbledhja e IX-të e rregullt e Asamblesë Komunale, me dt.30.11.2022.

Në mbledhje ishin prezent: 25 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, KFOR-i, OSBE, OJQ.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Model Rregullores për transportin public në teritorin e komunës së Deçanit,
3. Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit në mjedis-revidim,
4. Të ndryshme (Përgjigjet e Kryetarit të Komunës në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit të cilat dorëzohen me shkrim në Sekretari të Kuvendit, së paku tri ditë para mbledhjes).

Kryesuesi e hapi mbledhjen e XIV-të me radhë, gjegjësisht mbledhja e IX-të e rregullt e Kuvendit, duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 25 anëtarë të Kuvendit (mungon me arsye, Yllarta Thaqi, pa arsye Shkelqim Tolaj).

Kryesuesi- e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë.

Mon Selmonaj-thotë se sipas planit të punës së Kuvendit sot është dashtë ta kemi për shqyrtim Raportin e auditorit të jashtëm dhe shtron pyetjen pse nuk ka ardhë për trajtim, si dhe nuk është sjellë sot procesverbali nga mbledhja e jashtëzakonshme e dt.03.11 e thirrur nga opozita., prandaj kërkoj sqarim për këtë lëshim.

Teuta Neziraj- thotë , meqenëse që nga data 25 dhjetor në Kosovë është fushata kundër dhunës në baza gjinore, propozoj ka thënë ajo që të futet në rend dite si pikë Puna e komunës dhe drejtorisë së Shëndetësisë dhe angazhimet rreth kësaj teme.

Kryesuesi- ka thënë se raportin e auditorit të jashtëm do ta kini për shqyrtim në muajin dhjetor për arsye se drejtoresha e drejtorisë për Buxhet ka munguar në këtë mbledhje për arsye shëndetësore, ndërsa për propozimin e Teutës vendosni ju vet si kuvend si do ta trajtojmë.

Orges Tafilaj- pika nr.2 të hiqet nga rendi i ditës me arsyetimin se nuk na kini paisë me material.

Erdogan Dautaj- pajtohem me vërejtjen se për pikën nr.2 nuk na ka ardhë materiali.

Teuta Neziraj- thotë se sot është dashtë që edhe salla e kuvendit të jetë portokalli sepse janë 16 ditë aktivitet për kampanjën kundër dhunës në baza gjinore, aktivitete të cilat është dashtë të bëhen nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi.

Erdogan Dautaj- thot se pajtohem me kolegen, por për mbledhjen tjetër të mbetet kjo temë.

Kryetari i Komunës- ka kërkuar pak ma tepër sqarim nga propozuesja e temës, çka duhet të bëjmë ne konkret në këtë rast, sepse simbolikisht kjo fushatë nga ne është krye.

Hyri Dobrunaj-ka thënë, vetëm niveli i debatit për këtë temë është për keq ardhje, sepse është dashtë ju si komunë me na ardhë sot me një raport , çka kini ba si komunë në këtë drejtim, ndërsa sa i përket pikës nr.2, material nuk kemi, prandaj në mungesë të materialit, kjo pikë nuk bënë që të shqyrtohet.

Mon Selmonaj-thot se sot është dashtë të bëhet së paku një defilim në përkrahje të fushatës kundër dhunës.

Faton Selmanaj- thot se sipas asaj çka deklaroj kryetari paska informacione të mjaftueshme për kete temë.
Kryetari i Komunës- thot se asnjë shtet nuk e ka infrastrukturën ligjore ma të përgaditur se ne në këtë fushë, pajtohem me ju nëse duhet të bëhet ndonjë simbolikë, por mi ngritë një debat të tillë në kuvend nuk po e shof të nevojshme, sepse ne e kemi një sektor të shëndetësisë i cili i trajton këto tema, e kemi shpinë e sigurisë në të cilën si komunë participojmë financiarisht çdo vit, sektorin e sigurisë që vazhdimisht kujdeset për këtë çështje të sigurisë etj.
Albesa Cacaj- thotë pajtohem me kryetarin se kemi ligje për barazi gjinore, por nuk kemi zbatim të ligjeve.
Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e Teuta Neziraj që të hyn si pikë e veçantë për debat, me 15 vota për, 7 kundër dhe 3 abstenim kuvendi vendosi që të hyn në rend dite, _Debat lidhur me fushatën kundër dhunës në baza gjinore.
Kryesuesi- e qiti në votim propozimin e Orges Tafilaj- që të hiqet nga rendi i ditës pika nr.2, me 15 vota që kjo pikë të shqyrtohet sot sipas renditjes se rendit te punës dhe 10 vota qe kjo pikë mos të shqyrtohet, kuvendi vendosi qe pika nr.2 të shqyrtohet sot sipas rendit te punës.
Kryesuesi- e qiti ne votim rendin e plotë të punës, me 15 vota për dhe 10 kundër miratohet rendi i punës.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Orges Tafilaj- fillimisht thot se procesverbali sipas tij ka mungesa të mëdha, në vazhdim kërkon të plotësohet procesverbali te fq.2. me tekstin" mbi 90.000 euro dreka dhe mbi 1.2 milion shpenzim i buxhetit me përmbarues", në fq.3, para tekstit "dënoj gjuhën që ka drejtoresha .." të plotësohet me këtë tekst" dënoj gjuhën që ka përdorë drejtoresha e buxhetit për opozitën" dhe sërish kërkon që seancat e kuvendit të transmetohen live.
Me këto vërejtje dhe korrigjime miratohet procesverbali.
II.Shqyrtimi dhe miratimi i Model Rregullores për transportin publik në territorin e komunës së Deçanit.
Kryesuesi- e ka prezentu Model rregulloren për transport publik, pastaj ka shtuar se si dokument i ka kaluar procedurat e parapara ligjore, është mbajte diskutimi publik dhe sot e kemi në shqyrtim dhe miratim, pa ndonjë propozim për ndryshim.
Orges Tafilaj- thotë, vota ime do të jetë kundër dhe kjo në mungesë të informacionit dhe dokumentacionit për këtë pikë.
Florim Mataj- kërkon që të qitet në votim, meqenëse janë krye të gjitha procedurat e shqyrtimit të kësaj rregulloreje.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë se akti final duhet të vjen në kuvend si Rregullore, jo Model rregullore.
Kryetari- ka thënë se deri në momentin e fundit teksti mund të plotësohet dhe ndryshohet, prandaj quhet propozim, draft ose model, sepse ende nuk e ka marrë formën përfundimtare dhe mund të ndryshohet si tekst në çdo kohë, deri në momentin kur votohet në Kuvend.
Albesa Cacaj-thotë se neve na nevojitet rregullorja mu zbatu, jo për garë si tha kryetari, dhe ju si komunë duhet mi ndryshu ketë mentalitet.
Kryetari- në momentin qe thu se nuk po zbatohen rregulloret atëherë e ki për detyrë ti Albesë dhe çdo njëri që mendon ashtu , që të ceket me emër, cila rregullore nuk është zbatuar dhe në cilin nen është shkelë ajo.
Huri Dobrunaj- arsyeja pse ne po kërkojmë material për ketë pikë është se ne i kemi dhanë do vërejtje dhe te shikojmë se a janë bërë përmirësimet në tekst.
Izet Zenuni, drejtor i drejtorisë për SHP, i cili është edhe propozues i kësaj model rregullore, ka thënë se një ndryshim i vogël është propozuar nga Moni, kurse ju si LDK kini lypë stacion të autobusëve, dhe ky nuk është propozim për ndryshim në tekst të rregullores.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë se ne nuk jemi kundër përmbajtjes së tekstit të rregullores sot, por kemi problem se nuk e kemi materialin final..
Florim Mataj- thotë, pi votojmë rregulloren me propozimet konkrete që do ti bëni këtu sot dhe pastaj me ato ndryshime nxjerrët teksti final dhe nënshkruhet rregullorja.

Erdogan Dautaj- thotë sot pi votojmë kështu por kërkon që herave tjera me qenë ma e kujdesshme sekretarja e kuvendit dhe me na pajisë me material për çdo pikë që del në rend dite.
Kryesuesi- e qiti në votim, antarët e kuvendit e miratojnë Rregulloren për transport publik në territorin e komunës së Deçanit, rezultati votimit ishte, 15 për (pozita) 10 kundër(opozita).
III.Shqyrtimi i Planit lokal të veprimit në mjedis-revidim.
Kryesuesi- e ka prezentu kete pikë pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit të drejtorisë për Urbanizëm , Ramë Melaj, i cili ka dhënë sqarime rreth planit të prezentuar.
Mon Selmonaj-thotë, për të qenë funksional ky Plan Lokal i veprimit në mjedis duhet paraprakisht të kemi Planin Zhvillimor Komunal, sepse ne përveç Statutit të Komunës, si akt, nuk e kemi ende Planin Zhvillimore Komunal të miratuar(PZHK), i cili është bazë për një zhvillim të qëndrueshëm të Komunës, si dhe ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve që ka komuna jonë. Prandaj si i tillë, pa miratimin e ZHK-së, bjen ndesh me njërin nga dy dokumentet bazike të komunës, dhe si mund të jetësohet ky plan, pa u miratuar njëra nga shtyllat kryesore të funksionimit të tij.
Drejtori, Ramë Melaj- ka thënë se ne e kemi një plan të miratuar ma herët, ky tash është vetëm revidim i tij, ndërsa PZHK-në e kemi në procedurë të hartimit.
Mon Selmonaj- të miratohet një herë PZHK e pastaj ky Plan.
Miftar Ahmetxhekaj- thotë, Planet e veprimit i kanë tri faza mbi të cilat duhet të hartohet çdo plan, periudha kohore duhet të ketë koston e vetë, dhe në fund shtron pyetjen, a ka autor ky plan.
Krytari-thotë se ne e kemi pasë një Plan të veprimit në mjedis, dhe tash këtu po bëhet vetëm revidim i tij, prandaj kërkoj nga ju sot ta epni miratimin tuaj, në mënyrë që të vazhdojmë tutje dhe ti bëjmë ndërhyrjet e nevojshme që duhet bërë.
Faton Selmanaj- pyet, cilat janë objektivat dhe prioritetet e këtij plani.
Hyri Dobrunaj-thotë se ne kemi menduar se ky Plan do të na vjen për shqyrtim pas miratimit të PZHK-së, si dhe për hartimin e këtij plani ka thënë ajo duhet të angazhohen ekspert të fushave përkatëse.
Kryetari- na e kemi pasë një Plan i cili i ka skaduar mandati, dhe tash ai Plan po revidohet.
Ajne Iberhysaj, hartuese e Planit, sqaron rreth planit dhe hapat qe duhet të merren deri në miratimin përfundimtarë, plotësimet në tekstin e planit bëhen gjatë diskutimit, dokumenti është në harmoni me të gjitha ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe nuk kërkohet të jetë në harmoni me dokumentet tjera të komunës, unë, thotë ajo, e kam pasë sjellë një kalkulim financiar me një kosto që nuk është miratu këtu nga ju, nga ne kërkohet të paguajmë ekspertët sepse ata nuk na vijnë këtu pa pagesë.
Leotrim Hadergjonaj- meqenëse e kemi pasë këtë plan të miratuar një herë si dokument në Kuvend dhe tani vetëm i ka skaduar afati dhe përderisa nuk kemi propozime konkrete për ndryshime, ne duhet ti japim komplimente Ajnës për hartimin e këtij dokumenti me rëndësi dhe të vazhdojmë tutje me procedura.
Orges Tafilaj-sugjerimi im ka të bëjë me të dhënat e prezantuara në plan , nga të cilat një pjesë tani më veq janë vjetruar dhe duhet të ripërtërihen, prandaj pyetja ime është, ku janë marrë të dhënat, në fq.34 ka gabime në shifra, por mua më interesojnë të dhënat nga komuna ime, dhe pyetja ime a kemi me i pasë edhe në të ardhmen problemet që kanë qenë lidhur me këtë plan.
Faton Selmanaj- pyetje për statistikat, të dhënat janë të prezantuara vetëm deri në vitin 2019.
Florim Mataj- kërkon që të bëhet një komision dhe të viziton monumentet e trashëgimisë kulturore, duke kërkuar konkretisht të vizitohet kulla në Baballoq dhe të ndërmerret diçka aty.
Adem Lushaj- thotë se kam qenë bartës-bashkëkordinatorë me Ajnën, të hartimit të projektit të parë të planit, atë kohë kemi pasur edhe ekspert të angazhuar në 2017-ën, këtë e them për t'ju njoftuar se plani i parë është hartuar nga ekspertët.
Ramë Melaj- të gjitha vërejtjet do të inkorporohen në tekstin e planit, puna po bëhet nga ekspertët, një kosto financiare e kemi përgatitë dhe është mirë që të miratohet për të pasur mundësi të ecim tutje në hartimin e planit.
Ajne Iberhysaj- sqaron rreth Statistikave të prezantuara në plan, ajo thotë se të dhënat i kemi marrë nga UNDP , por prezantohet pjesa ma specifike e komunës se Deçanit, të dhënat janë të prezantuara vetëm deri në vitin 2019 sepse është bërë regjistrimi në atë vit dhe nuk kemi të dhëna tjera zyrtare.

Miratohet në parim Plani me shumic votash, 22 për 3 apstenim(LVV), në procedurë të mëtutjeshme del në diskutim publik.
IV.Të ndryshme.
Nuk ka kërkesa me shkrim.

- Njoftim për situatën e krijuar pas reshjeve të shiut dhe vërshimet nga shtretërit e lumenjëve.

Izet Zenuni, drejtor i drejtorisë për SHP ka njoftuar për vërshimet e ndodhura pas reshjeve të mëdha të shiut.
Florim Mataj- ka kërkuar që në fshatin Baballoq të rregullohen sa do pak urat para hymjes së disa shtëpive që të kenë mundësi banorët për qasje në shpitë e tyre.
Drejtori,Izet Zenuni-ka thënë që nesër ajo temë do të mbyllet.
Faton Selmanaj- Ura e Vranocit, a ka plan konkret për te.
Drejtori Izet- përgjigjet se inspekcioni ja ka qitë shiritat, FSK-ja do ta ngritë një urë mobile për peshën 3-5 ton, rruga alternative do të jetë Vranoc-Lumbardh.
Erdogan Dautaj- ka ngritë çështjen e kanalit të ujitjes Deçan-Dranoc në fshatin Carrabreg ky kanal është pikë e rrezikut ku po vërshon ky kanal, për të cilin drejtori ka dhënë sqarime.
Faton Selmanaj- thotë në Vranoc shum afër urës po tehiqet zhavorr, gjë që është e rrezikshme dhe kërkon që të del në teren Inspektorja e Ambientit dhe ta shef për së afërmi degradimin e shtratit të lumit., për të cilin drejtori ka thënë se do ta kemi parasysh këtë çështje,
Mon Selmonaj- sugjeron që ju si ekzekutiv ta vlerësoni urën mbi lum në fshatin Rastavicë, të bëhet vlerësim se a mund ta përballon ajo urë prap kalimin mbi te.
Miftar Ahmetxhekaj-ka ngritë çështjen e bllokimit të gypit të ujit te Sheshi Rrustem Bruqi në fshatin Isniq duke kërkuar që të intervenohet aty dhe të ndalet uji që vërshon rrugën, për të cilën drejtori përgjigjet se aty është blloku ura por do të intervenohet aty.

- Njoftim nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për gjendjen e AMF-ve .

Drejtoresha, Agnesa Vokshi- ka sqaruar se kjo kërkesë ka rrjedhë nga një emision i transmetuar televizion, pastaj sqaron komuna jonë i ka tri AMF dhe ato në fshatin Pobergj, Prapaqan dhe Lumbardh, mirëpo në ato AMF asnjë pacient nuk shkon dhe nuk është krijuar kjo situatë aty sepse ne nuk dëshirojmë të punojmë por se aty nuk shkon asnjë pacient.
Orges Tafilaj- pyet, a po shkojmë drejt mbylljes së AMF-ve sipas këtij informacioni.
Arjan Dobraj- pyet, kurë bëhet furnizimi me barna nga lista esenciale në ambulanten e fshatit Gramaqel si dhe potencon se nuk qëndron fakti se mjeku shkon 2 herë në javë në këtë ambulantë edhe pse thuhet ashtu.
Agnesa Vokshi- thotë se dy herë në javë shkon mjeku në ambulanten e fshatit Gramaqel.
Doktoresha, Lulavere Qorraj-Selmanaj-sqaron rreth punës së mjekut në ambulanten e fshatit Gramaqel, ajo thotë se mjeku që është i caktuar për të punuar dy herë në javë në ambulanten e fshatit Gramaqel, i njëjti e ka edhe një detyrë tjetër- është Koordinator i cilësisë, dhe sipas ligjit ai mjek katër orë të punës së tij duhet të punon si koordinator i cilësisë, mirëpo duhet të ceket se ky mjek është shumë i përgjegjshëm për punën që bënë.
Mon Selmonaj- pyet, a kini ndërmarrë ndonjë veprim që të rritet kapaciteti i laboratorit sepse kishte shumë pacientë aty.
Drejtoresha ka sqaruar për angazhimet në këtë drejtim.
Erdogan Dautaj-pyet, a ka mundësi të zëvendësohet mjeku që shkon në ambulanten e fshatit Gramaqel pasi që ka punë tjetër i angazhuar në punë administrative, dhe pse nuk bëhen të gjitha analizat në QKMF, për të cilën drejtoresha përgjigjet se nuk na lejon ligji.
Leotrim Hadergjonaj-thotë para një jave kam qenë në QKMF dhe komplimente për punën e mirë që po bëhet aty.

- Diskutim rreth temës së dhunës në baza gjinore.

Teuta Neziraj, propozuese e kësaj teme ka thënë, se me qenë se ndodhemi në fushatën 16 ditore kundër dhunës në baza gjinore, fushatë e cila zgjatë deri me dt.10 dhjetore, ishte e nevojshme që edhe ne si kuvend i komunës t'ia kushtojmë një debat kësaj teme, sepse dhuna ndaj grave është e papranueshme, viktimat nuk duhet të fajësohen asnjëherë, dhe kjo sallë në shenjë përkrahje të kësaj fushate sot është dashtë të jetë krejt portokalli, pastaj shtron pyetjen për kryetarin e komunës, çka

kini bërë ju si komunë në përkrahje të kësaj fushate, pastaj ka cekë faktin se ne si kuvend kemi formuar komisionin për hartimin e planit për barazi gjinore por që nuk ka rezultate në këtë drejtim
Leotrim Hadergjonaj-thotë, meqenëse fushata është deri me dt.10 dhjetor atëherë propozoj që ne si asamble ta bëjmë një aktivitet në përkrahje të kësaj fushate.
Drejtoresha Agnesa Vokshi- thotë se kemi planifikuar që ta mbajmë një aktivitet me dt.10 dhjetor edhe pse është ditë vikendi-e shtunë..
Faton Selmanaj- propozon që të mbahet një tryezë e përbashkët ku do të marrin pjesë përfaqësues nga policia, QPS, Asambleja, OJQ, që bashkërisht të debatojmë rreth kësaj teme të ndjeshme.
Orges Tafilaj- pyet, rreth punës që ka bërë komisioni i kuvendit për hartimin e planit për barazi gjinore.
Hyri Dobrunaj-thotë, dëshiroj që të kemi statistika sa është sipas statistikave dhuna në baza gjinore në komunën e Deçanit, pastaj propozon që si kuvend së paku ta bëjmë një ecje në përkrahje të fushatës, si komunë të bëjmë grupe mbështetëse për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, në të cilin do ta epnin kontributin e vet edhe drejtoria për Shëndetësi dhe Drejtoria për Arsim dhe kishte qenë mirë që policia me na dhanë shifra të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna, por jo me emra.
Kryesuesi-ka kërkuar nga drejtoresha për Shëndetësi që të angazhohet për organizmin e aktivitetit kundër dhunës në baza gjinore, në të cilin aktivitet do të jemi pjesëmarrës edhe ne si kuvend, dhe e mbylli debatin rreth temës duke dëshiruar që mos të kemi kurrë raste të dhunës.
Arjan Dobraj-prezanton një kërkesë të fshatit Gramaqel për intervenim në rrjetin elektrik sepse janë keq në këtë drejtim.
Izet Zenuni- thotë, kërkesa e para dy muajve që e ki bërë ti, na si Komunë e kemi drejtu te KEDS-i sepse ata janë kompetent për këtë gjë. Por ende nuk kemi marrë përgjigje nga ata, mirëpo edhe pse KEDS-i është kompetent për ate çështje , nëse ata nuk intervenojnë, na me ndriçim publik i evitojmë ato defekte.
Erdogan Dautaj- ka ngritë çështjen e telave të rrymën nëpër rrugën Qendra.
Hyri Dobrunaj-pyet, ku i kini gjete ju tri ditë para mbledhjes për dorëzim të kërkesës me shkrim të asamblistëve në kuvend, ne e kemi thirre një mbledhje të jashtëzakonshme dhe unë kam fole si shefe e grupit të asamblistëve të LDK-së jo si individ, dhe kërkoj nga Kryesuesi që ta tërheqë fjalën tij, të kërkon falje për ato fjalë, sepse unë kam dashtë me reagu në rrjete sociale, por nuk kam dashtë dhe nuk dëshiroj që punët e asamblesë të përzihen me çështje private dhe familjare.
Kryetari- thotë se këto tema nuk janë për debat në kuvend.
Kryesuesi- thotë se unë jam këtu në pozitën e kryesuesit të kuvendit sepse më ka sjellë një subjekt politik dhe natyrisht edhe me votat e qytetarëve, por nuk jam i pavarur, ju si opozitë kini kërku debat me kryetarin e komunës dhe për këtë e kini bërë kërkesën për thirrje të mbledhjes së jashtëzakonshme, unë si kryesues në bazë të kërkesës suaj e kam ftu mbledhjen e jashtëzakonshme sipas kërkesës suaj, debat me kryetarin e komunës, por jo me asamblistë, Kryetari ka qenë i pranishëm në sallë sepse e kini ftuar për debat, por asamblistët jo , sepse nuk kanë qenë të interesuar, dhe nuk mund të obligohen kundër vullnetit të tyre, mirëpo unë si kryesues kam qëndruar këtu me ju në sallë.
Erdogan Dautaj-thotë qe pesë vjet që jam pjesë e kuvendit na kurr nuk e kemi lëshuar veten në kësi debati të ulët për nivelin e kuvendit, dhe unë në mënyrë demonstrative do ta lëshoj sallën në shenjë mos pajtimi me këtë nivel debati, në vazhdim Erdogan Dautaj e lëshon sallën në shenjë mos pajtimi me mënyrën e zhvillimit të debatit në Kuvend.
Mon Selmonaj- thotë, si ma i vjetri këtu nga asamblistët kërkoj që të kemi kujdes dhe ta ruajmë gjuhën e debatit, sidomos ata që udhëheqin, në vzhdim Moni ka ngritë disa çështje dhe ka bërë këto pyetje:
1.Z.kryetar, ju lutem na njoftoni për vizitën tuaj, në përbërje të delegacionit të ministrit të Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe homologëve nga pala malazeze në komunën e Rozhajës.
Cila është perspektiva dhe opinionet e të dyja palëve nga ky takim, për rrugën Deçan-Plavë.
2.Informim rreth hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal(PZHK) dhe Hartat Zonale Komunale (HZK).

Cila është arsyeja e mos arritjes në kuvend të këtyre dy dokumenteve bazike.
3.Deri ku kini arritur që ta shndërroni Kullën Kala (në Bjeshkë të Strellcit) në qendër rezidenciale komunale. Cilat janë arsyet dhe benefitet e këtij ndërrimi, a kini llogaritur në problemet apo pengesat, siq është leja e ndërtimit, kostoja e ndërtimit etj.
Nuk besoj që një investitor privat ia falë komunës tërë atë investim pa pasur arsye të mëdha, siq është fshehja e njëfar legjitimiteti pa leje të këtij ndërtimi..
4.z.Kyetar, ditë më parë, përmes faqes zyrtare të komunës kini njoftuar për lëshimin në përdorim të antenës së valës në bjeshkë.
Pyetja: a është ky financim i Postelekomit, apo bashkëfinancim me komunën, dhe nëse është bashkëfinancim, cila është mënyra financimit sepse ne nuk e kemi hasë në raportin financiar 9 mujor.
5.Në mbledhjen e shtatorit, në të cilën është shqyrtuar dhe miratuar buxheti për vitin 2023 i kam ngritur disa çështje për të cilat nuk kam marrë përgjigje, besoj se sot jeni i gatshëm zoti kryetar.
Cili është vizioni apo qasja juaj në vitin 2023, për zvogëlimin e numrit të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta dhe ndaj vendimeve gjyqësore përmbarimore të cilat vendime në 9 muajt e këtij viti, kanë arritur shifrën 1,281,428.00 €.
Kam kërkuar të dijë kuvendi për disa projekte që janë në zhvillim e sipër si: fshatrat turistike, shtëpia Alpine, Kolonia e Artistëve etj. Në menaxhim të kujt do të jenë, statusi i tyre dhe benefiti që do të ketë komuna si investitorë.
6.Disa herë, unë dhe kolegët tjerë kemi kërkuar listën e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim dhe raportet financiare nga këto të hyra dhe ato të 21%. Poashtu kërkoj sqarim se ku u tretën zyret e ish kontabilitetit shoqërorë, që ishin në objektin e rrënuar tashmë.
A ka të hyra nga këto prona të komunës, dhe a do të bëhen publike ndonjëherë ato.
Kryetari- përgjigjet në çështjet e ngritura më sipër.
Vizita ime me ministrin e infrastrukturës në Rozhajë, kemi qenë të ftuar unë dhe kryetari i Pejës, këtu është nënshkruar një marrëveshje jo shumë bazike (Mali i Zi i kan 8 km të rrugës Deçan-Plavë), dhe Mali i Zi nuk e kan në objektivat e veta financimin e rrugës në territorin e vet me gjatësi 8 km., për momentin nuk mendoj se mali i Zi ka për qëllim të merret me këtë rrugë sa i përket çështjes financiare. 2.PZHK është shndërrua në një telashe mes neve dhe Ministrisë së linjës për shkak të disa synimeve dhe objektivave tona dhe kjo falë resurseve tona që na i ka falë Zoti dhe ne dëshirojmë ti shtimë në funksion, janë duke u punuar dy planet, unë nuk jam i gatshëm me hjekë dorë nga synimet që i kam brenda këtij plani. 3.Objekti i Qendrës Rezidenciale- a ka leje apo jo, ajo është bërë një objekt që duhet mu ni mirë dhe krenarë gjithë shteti i Kosoves, shpresoj që në atë objekt të mbahen takime të nivelit të lartë, pa prejudiku a ka leje apo jo.
4.Antena Vala, angazhimet tona kanë qenë shumë të zorshme në atë projekt.5.Shtëpia Alpine dhe Kolonia e Artistëve janë dy projekte që ne i kemi bërë duke kaluar në sfida shumë të mëdha, shpresoj që në vitin tjetër do të përmbyllet si projekt Shtëpia Alpine, ndërsa Kolonia e Artistëve është projekt në përfundim, Puntorët me kontratë në vepër- për këte jam deklaruar edhe ma herët bile edhe gjatë fushatës.
Pronat Komunale-është një evidencë e vitit 2016 por duhet të bëhet edhe një vlerësim dhe klasifikim vitin tjetër.
Faton Selmanaj- pyetje, pengesat e vendosura në rrugën kryesore Qendra-lartësia e tyre është shumë e madhe dhe po paraqesin pengesë që qarkullimin e qytetarëve, Garat e veturave nga lokali i Dugit deri te pompa Agonisi –Gas po paraqesin rrezik për qarkullimin e lirë të qytetarëve.
Kryetari përgjigjet, për gara të veturave policia disa herë kanë vepru aty por edhe përkundër dënimeve të ashpra ata nuk po nalen, pengesat e vendosura ne rrugë, kam kërkesa qe këto te shtohen prap, por ka kërkesa edhe mu hjeke, por edhe janë të venojshme pengesat për siguri të qytetarëve për kohën që ka ardhë.
Faton Selmanaj- lartësia e pengesave duhet të ulet dhe rrafshohet pak nga sa është tash.
Albesa Cacaj-investimet në shkollën Lidhja e Prizrenit, neglizhenca e kryerjes së punëve aty, sepse po rrezikohet jeta e fëmijëve aty, ka mungesë të materialeve esenciale në shkollë siq është letra e
bardhë, braktisja e shkollës nga nxënësit që ju takojnë komuniteteve pakicë, çështje e ngritur edhe në Komitetin e Komuniteteve, a je në dijeni kryetar se në shkollën në Gramaqel ja kanë dhuru një Ajped një nxënësi nga komuniteti pakicë dhe prap ja kan marrë.
Kryetari përgjigjt dhe sqaron në çështjet e ngritura.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ